



Prishtinë, 12 tetor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_461_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 dhe 2.16, nenin 25 dhe Nenit 38 paragrafi 4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në lokacionin “Te Pishat” Shtime, të datës 22.09.2009 të ndërmarrjes “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k, me adresë rruga “Tirana” nr. 2, KK Shtime, Republika e Kosovës;

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. **PËRFUNDON** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_241_2010 i datës 24 mars 2010 dhe Vendimit për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_405-2012 i datës 15 qershor 2012.
- II. **REFUZOHET dhënia e AUTORIZIMIT** ndërmarrjes “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW), sh.p.k, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në lokacionin “Te Pishat”, KK Shtime.

Arsyetim

- ZRRE me datë 22.09.2009 nga ndërmarrja Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 100 MW, në lokacionin “Te Pishat”, KK Shtime.
- Me datë 24 mars 2010 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga ndërmarrja “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteti të ri gjenerues nga era dhe ka lëshuar Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_241_2010.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në vendim është përcaktuar se ndërmarrjes “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., do t’i lëshohet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afatit do të bëjë një kërkesë me shkrim për



shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.

- Me datë 01.03.2012 ZRRE nga ndërmarrja “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar edhe për një vit, deri me 24.03.2013.
- Me datë 15 qershor 2012 Bordi i ZRRE-së, me vendimin V_405_2012 ka vendosur që ndërmarrjes “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., ti SHTYHET afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me 24 shtator 2012, në pajtim me Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja.
- ZRRE deri me datë 24 shtator 2012 nga ndërmarrja “Kosova Ter. Windparkcompany” (KTW) sh.p.k., nuk ka pranuar kërkesës për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimit Preliminar në Autorizim, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi, andaj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar